

SYLLABUSI

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Inxhinierisë dhe informatikës		
Titulli i lëndës:	Grafika Inxhinjrike		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	3		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Gjelosh Vataj		
Detajet kontaktuese:	gjelosh.vataj@ushaf.net		
Përshkrimi i lëndës	<p><i>Kjo lëndë do ti njoftojë studentët me njohuritë për standardet e vizatimit teknik. Vizatimi Teknik në përgjithësi. Formatet, përpjesa, tabelat. Llojet e vijave, vizatimi i konturave gjeometrike. Shkrimi teknik. Dimensionimi dhe kuotimi. Prerjet. Skicimi. Paraqitja e vizatimeve teknike. Gjeometria descriptive. Projektimi i elementeve gjeometrike. Transformimi. Rotullimin. Formimi i trupave. Prerjet e trupave. Ndërhyrjet e trupave etj</i></p>		
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Qëllimi i lëndës është përgatitja e studentëve me metodat e themelore të vizatimit teknik dhe gjeometrisë deskriptive.</i></p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti do të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të njohin shkrimin teknik, llojet e vijave, llojet e formateve, tabelat;</i> • <i>Të kuptojnë vizatimin dhe skicimin e objektevetë ndryshme gjeometrike;</i> • <i>Të zbatojnë rregullat e dimensionimit, paraqitjen e pikave, vijave dhe trupave nëhapësirë;</i> • <i>Të krijojnë vizatime teknike dhe inxhinierike;</i> • <i>Të zhvillojnë me sukses projekte inxhinierike duke përdorur njohuri teknike për vizatimin.</i> 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Mësimdhënie (ligjërata dhe ushtrime)	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	-	-	-

Kollofiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	3	8	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	1	1
Projektet, prezantimet ,etj	1	1	1
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Kursi zgjat 15 javë me 3 orë leksione dhe/ose ushtrime javore individuale dhe grupore. Ushtrimet do të mbahen në formën e punës individuale dhe grupore në të cilën do të diskutohen shembuj konkretë. Pjesëmarrja aktive është jashtëzakonisht e rëndësishme, kështu që studentët inkurajohen që të ndjekin rregullisht leksione dhe ushtrime dhe të kontribuojnë në diskutimet që zhvillohen në leksione. Ligjërata, Ushtrime, punë individuale, diskutime dhe punë grupore		
Parakushtet	Studenti duhet të ketë një ide të përgjithshme rreth lëndës Grafika Inxhinjrike, si dhe të paktën të ketë njohuri të mira në Vizatimin Teknik dhe Gjeometri Deskriptive qe perdorën sot ne Botë.		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Studenti mund të vlerësohet ne njëren nga dy format e vlerësimit te dhënë më poshtë:</i></p> <p>1. Forma 1: Vlerësimi me kollokviume dhe projekt</p> <p>2. Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar.</p> <p>Forma 1:</p> <p><i>Në formën e parë të vlerësimit" Vlerësimi me kollokviume dhe punim seminarik, "studenti vlerësohet në katër aktivitete që realizohen gjatë ligjëratave:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kollokvium 1 (35%), vlerësim individual 2. Kollokvium 2(35%), vlerësim individual 3. Aktiviteti në klasë(10%), vlerësim individual 4. Projekti (20%), vlerësim individual ose grupor. <p><i>Sqarim shtese:</i></p> <p><i>Nëse studenti në secilin aktivitet të mësipërm arrin pikët maksimale, atëherë ai do të vlerësohet me 100 pikë. Studentët të cilët e kalojnë provimin sipas formës 1 të vlerësimit, lirohen nga obligimi për t'iu nënshtruar provimit final.</i></p> <p><i>Vetëm nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t'i nënshtrohet provimit final për të përfituar vlerësim më të lartë.</i></p> <p>Forma 2:</p> <p><i>Në formën e dytë të vlerësimit" Vlerësimi me provimin përfundimtar", studentit do t'i nënshtrohet provimit i</i></p>		

	<p>cili mbahet pas përfundimit të ligjëratave të lëndës, dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Unioersitetit.</p> <p>Përmes provimit final studenti maksimalisht mund të arrijë 80% të pikëve nga totali prej 100 pikë.</p> <p>Pjesa tjetër e pikëve prej 20% duhet të plotësohet nga puna individuale ose grupe në Projekt, aktivitetet i realizuar gjate ligjëratave.</p> <p>Në Kollokvium1, Kollokvium 2 dhe Provim përfundimtar vlerësimi i studenteve do të bëhet përmes një formulari vlerësimi, i cili duhet te plotësohet ne mënyrë individuale nga studenti.</p> <p>Formulari i vlerësimit do të përmbajë pyetje te shperndara ne menyre proporcionale me ligjerata e kryera gjate semestrit, materialin e lëndës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetjet subjektive do të jenë të llojit detyre me shkrim që do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit, nga përgjigjet e hartuara nga studenti ndaj pyetjes së parashtruar. • Aktiviteti në klasë-nënkupton angazhimin e studentit në trajtim të çështjeve të diskutuara ne klase, gjate ligjëratave. • Projekti (30%), vlerësim individual ose grupor: është aktivitet në të cilin studentet zbatojnë në një projekt konkret njohuritë e fituara. Realizohet vetem një student ose në grup prej 2 ose 3 studenteve te cilët kanë për obligim ta realizojnë aktivitetin, dokumentojnë edhe prezantojnë para profesorit të lëndës. <p>Për formën e realizmit dhe dokumentimit te aktivitetit të gjithë anëtarët e grupit do të vlerësohen me pikë të njëjtë(10%), kurse vlerësimi i aftësive prezantuese të aktivitetit është individual dhe përfshinë 10%.</p> <p>Vlerësimi:</p> <p>91-100 pikë – vlerësohet me notë 10(dhjetë)</p> <p>81-90 pikë – vlerësohet me notë 9(nëntë)</p> <p>71-80 pikë – vlerësohet me notë 8(tetë)</p> <p>61-70 pikë – vlerësohet me notë 7(shtatë)</p> <p>51-60 pikë – vlerësohet me notë 6(Gjashte)</p> <p>0-50 pikë – Studenti ri-përsëritë në provim.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bajraktari M. dhe Doçi I. Vizatimi Teknik, Prishtinë, 2014 2. Bajraktari M. Gjeometria Deskriptive, Prishtinë, 2004. 3. Wiliam P. Spence: Drafting Technology and Practice, Peoria, Illinois, 1980. 4. K.C. John, Engineering Graphics for Diploma, PHI Learning Private Limited, 2009.

Literatura shtesë:	5. Bajraktari M. dhe Doçi I. <i>Prezetime nga GrafikaInxhinierike, Prishtinë, 2014.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<i>Hyrje në Grafiken INxhinjerike (vizatim teknik dhe gjeometri deskriptive). Informacionerreth kursit.</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>Llojet e vizatimeve. Standardet. Numrat standard.</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>Llojet e vijave. Formatet e vizatimit. Përpjesat e vizatimit teknik.</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>Vizatimi i konturave gjeometrike. Tërheqja e drejtëzave dhe këndeve. Konstruktimi i harqeve dhe tangjentave. Konstruktimi Ilakoreve: elipsës, parabolës, hiperbolës, cikloidës, spirales dhe sinoidës.</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>Shkrimi teknik. Llojet e shkrimit. Simbolet.</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>Dimensionimi. Rregullat e dimensionimit dhe kuotimit.</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<i>Testi i Parë</i>
<i>Java e tetë:</i>	<i>Materialet në vizatim teknik. Cilësia e sipërfaqeve dhe shenjat ecilësisë.</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>Projektimi. Llojet e projektimit. Projektimi ortografik dhe persprktivë.</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>Prerjet. Prerje e objekteve me rrafshe në pozita të ndrushme.</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Paraqitja e vizatimeve. Skicimi. Paraqitja e skicave. Paraqitja e detajeve në tre projeksione orthogonal. Paraqitja e objekteve ne vizatim teknik me të gjitha elementet.</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Shembuj të ndryshëm.</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>Projektimi i pikes. Projektimi i drejtëzës. Paraqitja e objekteve nëvizatim teknik me të gjitha elementet. Trahsfomimi. Formimi i trupave.</i>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<i>Projektimi i trupave. Prerja e trupave. Ndërhyrja e trupave.</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Testi i dytë.</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.